



Auels 225

## SHOQERIA "LIRENG AUDITING" SH.P.K

Adresa: Rruga "Dibres" Pall.324/1 Tirane  
Email: lireng.auditing@gmail.com  
Tel/Fax: +355 42 450 952  
Mob: 0672079155

### Raporti i Audituesit

**Asamblese se Pergjithshme:  
Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar**

*Tirane, Rruga Muhamet Gjollësia, Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori*

#### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të "Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar" (OJF), Tirane të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e ardhurave dhe shpenzimeve gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël me të rëndësishme.

Sipas opinionit tone pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, të marra në tërësi dhe në të gjithë aspektet materiale, në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr 64 dt 22.07.2014 "Për shpalljen e detyrueshme të tyre", pozicionin financiar të "Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar" (OJF), Tirane, me 31 Dhjetor 2017 dhe performancën financiare dhe të fluksit monetar për periudhën kontabël të mbyllur në këtë datë, të përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

#### **Bazat për opinionin**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Auditimit (SNA-te). Përgjegjësitë e tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë me të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga "Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar" (OJF) në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për t'u përdorur si baze në dhënie të opinionit tone të audituesit.

**Shtojcë e Raportit të Audituesit.**

Si pjese e auditimit ne perputhje me SNA-te, ne ushtrojme gjykimin profesional dhe ruajme skepticizmin profesional gjate gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojme dhe vleresojme rreziqet e anomalise materiale, qofte per shkak te mashtrimit ose gabimit, hartojme dhe kryejme procedurat e auditimit ne pergjigje te ketyre rreziqeve, dhe marrim evidence auditimi qe eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te siguruar nje baze per opinionin tone. Rreziku i moszbulimit te nje anomalie materiale si rezultat i mashtrimit eshte me i larte se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund te perfshije marreveshje te fshehta, falsifikime, perjashtime te qellimshme, informacione te deformuara, anashkalime te kontroleve te brendshme.
- Sigurojme nje njohje te kontrollit te brendshem qe ka te beje me auditimin me qellim qe te percaktojme procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme sipas rrethanave, por jo per qellime te shprehjes se ne opinionin mbi efikasitetin e kontrollit te brendshem te Shoqerise.
- Vleresojme pershtatshmerine e politikave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e cmuarjeve kontabel dhe te shpjegimeve perkatese te bera nga drejtimi.
- Nxjerrim nje konkluzion ne lidhje me pershtatshemrine e perdorimit te bazes kontabel te vijmesise, dhe bazuar ne evidencen e auditimit te marre, nese ka nje pasiguri materiale ne lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund te hedhe dyshime te medha per aftesine e Shoqerise per te vijuar veprimtarine. Nese ne arrijme ne perfundimin qe ka nje pasiguri ne duhet te terheqim vemendjen ne raportin e audituesit ne lidhje me shpjegimet e dhena ne pasqyrat financiare, ose nese keto shpjegime jane te pershtatshme, duhet te modifikojme opinionin tone. Konkluzionet tona bazohen ne evidencen e auditimit te marre deri ne daten e raportit tone te auditimit. Megjithate, ngjarja ose kushtet te ardhshme mund te bejne qe Shoqeria te nderprese veprimtarine.
- Ne komunikojme me personat e ngarkuar me qeverisjen, pervec te tjerave, lidhur me qellimin dhe kohen e auditimit dhe gjetjet e rendesishme te auditimit, perfshire ndonje mangesi te rendesishme ne kontrollin e brendshem qe ne mund te identifikojme gjate auditimit.

Audituesi

“LIRENG Auditing” Sh.p.k

Neshat MAZE (Ekspert Kontabel i Regjistruar)



Tirane, Prill 2018

***Përgjegjësia e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare***

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë e të drejtë në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe për ato kontrole të brendëshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak mashtrimit apo gabimit

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e (OJF) për të vazhduar në vijmësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijmësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijmësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë (OJF) ose të ndërpresë aktivitetin, ose nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të (OJF).

***Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare***

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo të gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijne si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Audituesi

"LIRENG Auditing" Sh.p.k

Neshat MAZE (Ekspert Kontabël i Regjistruar)



Tirane, Prill 2018